



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS, DHE SPORTIT
DREJTUESI I PROGRAMIT

Nr. 2410/1 Prot.

Patos, më 23.07 / 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 46, datë 23.07.2026



**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 VJEÇARE
“HEKURAN MANEKU”, DHE NDËRTIMI I PALESTRËS”, DHE
BASHKËFINANCIMIN NGA NJËSIA VENDORE**

Në mbështetje të nenit 34 dhe 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, shkresës nr. 4235/11 prot., datë 20.07.2026 “Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara”, Urdhëri nr.382 prot, datë 20.07.2026 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja 2026-2028, nga programet Arsimit Bazë, Arsimit i Mesëm, për infrastrukturën shkollore”, nga Ministria e Arsimit, në të cilën është konfirmuar miratimi i projektit fitues, dhe financimi i projektit të aplikuar nga ne në masën 85%, Ekipi i menaxhimit të programit pasi analizoi domosdoshmërinë e miratimit të vlerës së bashkëfinancimit, për të vazhduar me procedurat e mëtejshme,

KËRKON:

1. Të miratojë projektin “Rikonstruksion i shkollës 9 Vjeçare “Hekuran Maneku”, dhe ndërtimi i palestrës”, me vlerë projekti 160,318,555 lekë, me financim për vitet 2026-2028.
 - Financimi i këtij projekti në masën 85% me vlerë 136,270,772 lekë, do të mbulohet nga Ministria e Arsimit , në vitet 2026-2028.
 - Financimi i këtij projekti në masën 15% me vlerë 24,047,783 lekë, do të mbulohet nga Bashkia Patos si bashkëfinancim për vitin 2028.
 - Financimi i vlerës 3,000,000 lekë, për mbulimin e kostos për mbikqyrje, kolaudim, do të mbulohet nga Bashkia Patos, si pjesë e bashkëfinancimit.
2. Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit prej 27,047,783 lekë, në vitin 2028, e cila do të mbulohet brenda tavanëve buxhetorë të programit “Arsimi, Kultura, sporti, Çështje sociale”, në planin buxhetor AFM 2027-2029, me rishpërndarje vlere, të projekteve të parashikuara në këtë program.0

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës, Sportit, Drejtoria e Zhvillimit të Teritorit dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës, Njësia e Prokurimit.

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT

Drejtues i Programit
Mitjon Nikolla

ANËTARËT

Barie Goxhaj




Dorian Shpata



Lindita Qalliaj




Endrit Çako



Albora Sulaj



Grisilda Bektashi (Ruzaj)



Drejtoria e Zhvillimit të Teritorit dhe Emergjencave Civile
Boreta Murati



Juriste
Joana Sherifi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS, DHE SPORTIT
DREJTUESI I PROGRAMIT

Nr. 244/2 Prot.

Patos, më 23/07/2026

RELACION MBI PROJEKT-VENDIM

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 VJEÇARE
‘HEKURAN MANEKU”, DHE NDËRTIMI I PALESTRËS”, DHE
BASHKËFINANCIMIN NGA NJËSIA VENDORE**

KËSHILLIT TË BASHKISË

Bashkia Patos ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit për financim të projektit “Rikonstruksion i shkollës 9 Vjeçare “Hekuran Maneku”, dhe ndërtimi i palestrës”, një projekt i cili do të ofrojë kushte me të mira për zhvillimin e procesit mësimor. Me shkresën nr. 4235/11 prot, datë 20.07.2026 “Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara”, Urdhëri nr.382 prot, datë 20.07.2026 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja 2026-2028, nga programet Arsimi Bazë, Arsimi i Mesëm, për infrastrukturën shkollore”, nga Ministria e Arsimit, është konfirmuar miratimi fitues i projektit të aplikuar nga ne.

Godina në të cilën zhvillohet aktualisht mësimi është totalisht e amortizuar dhe ka nevojë për rikonstruksion total të ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu mungesa e ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive është një problematikë tjetër, e cila kufizon zhvillimin normal të mësimdhënies për të gjithë grupmoshat. I gjithë objekti ka prani të lagështirës, dyer dritare të dëmtuara, shtresat e dyshemesë dhe mureve si pasojë e mungesës së ndërhyrjes prej vitesh janë degraduar duke u kthyer në një problematikë për të gjithë nxënësit dhe stafin e mësuesve, sidomos përgjatë ditëve me reshje të dendura shiu. Oborri i shkollës do të rikonceptohet duke u përshtatur për gjithë grupmoshat me ambiente çlodhëse dhe argëtuese si dhe do të shoqërohet me ndërtimin e një palestere me kushte bashkëkohore duke ofruar kushte për zhvillimin normal të lëndës së edukimit fizik apo dhe më tej. Po ashtu në çdo kat do të rikonstruktohen tualetet, të cilat ishin në gjendje shumë të rënduar. Në këtë mënyrë do të ketë një mësim cilësor për të gjitha klasat që ka aktualisht shkolla duke krijuar mundësinë dhe për klasa të tjera të cilët pritet të shtohen pas rikonstruksionit total të shkollës.

Fondi për rikonstruksionin e shkollës në masën 85% do të mbulohet nga Ministria e Arsimit , dhe 15% nga bashkia Patos, me financim në vitet 2026-2028 .

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë projektin “Rikonstruksion i shkollës 9 Vjeçare “Hekuran Maneku”, dhe ndërtimi i palestrës”, me vlerë projekti 160,318,555 lekë, me financim për vitet 2026-2028.
 - Financimi i këtij projekti në masën 85% me vlerë 136,270,772 lekë, do të mbulohet nga Ministria e Arsimit , në vitet 2026-2028.
 - Financimi i këtij projekti në masën 15% me vlerë 24,047,783 lekë, do të mbulohet nga Bashkia Patos si bashkëfinancim për vitin 2028.

- Financimi i vlerës 3,000,000 lekë, për mbulimin e kostos për mbikqyrje, kolaudim, do të mbulohet nga Bashkia Patos, si pjesë e bashkëfinancimit.
2. Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit prej 27,047,783 lekë, në vitin 2028, e cila do të mbulohet brenda tavanëve buxhetorë të programit “Arsimi, Kultura, sporti, Çështje sociale”, në planin buxhetor AFM 2027-2029, me rishpërndarje vlere, të projekteve të parashikuara në këtë program.

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT

Drejtues i Programit

Mitjon Nikolla

ANËTARËT

Barie Goxhaj



Dorian Shpata



Lindita Qalliaj




Endrit Çako



Albora Sulaj



Grisilda Bektashi



Drejtorja e Zhvillimit të Teritorit dhe Emergjencave Civile
Boreta Murati



Juriste

Joana Sherifi

